



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:050331
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05525791

PPP.nr.13/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtaren Lirika Sylaj në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kreditimi Rural i Kosovës në Prishtinë – Dega në Istog, ndaj debitorëve Sh.A nga I. P, rruga “A.H”, Komuna e I., A.B nga fshati M. rruga “Martirët B” Komuna e Istogut dhe S.B nga fshati M., rruga “M.B”, Komuna e I. sipas bazës juridike borxh, në vlerë prej 10,182.9 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit ndaj Urdhrit Përmbartimor të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi P.nr.66/22 të datës 14.02.2022, jashtë seancës, me datë 29.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit Sh.A, i parashtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi P.nr.66/22 të datës 14.02.2022, ashtu që i njëjti urdhër MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Gjokë Radi, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit Kreditimi Rural i Kosovës – Dega në Istog me datën 14.12.2022 ka lëshuar Urdhërin Përmbartimor P.nr.66/22 me të cilin ka urdhëruar bllokimin e llogarive në bankat komerciale në emër të debitorëve si dhe Sekuestrimin e kolateralit/pengut, përmes së cilit është bërë sigurimi i marrëveshjes për kredi të datës 31.08.2020.

Kundër urdhrit të lartëcekur për lejimin e përmbartimit, brenda afatit të paraparë ligjor me datën 01.03.2022, debitori Sh.A ka paraqitur prapësim. Debitori prapësimin kryesisht e bazoj në pretendimet se me kreditorin ka arritur marrëveshje për pagesën e këtij borxhi me këste ku me datën 24.02.2022 janë paguar 1, 000 Euro, ndërsa, për pjesët e tjera do të paguhen sipas marrëveshjes. Po ashtu, theksohet se nga organi kompetent është vërtetuar gabimisht gjendja

faktike dhe pa kurrfar baze debitori është ngarkuar me borxhin në fjalë, prandaj gjykatës i propozoj që të anulohet propozimi për përmbarrim si i pabazuar dhe debitori të lirohet nga kjo shumë e borxhit pasi që me kreditorin është arritur marrëveshje lidhur me pagesen e tij.

Kreditori, me datë 02.03.2022 ka paraqitur përgjigje në prapësim, në të cilën ka theksuar se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar dhe i njëjti është paraqitur me qëllim të përfitimit në kohë dhe krijimin e vonesave në inkasimin e borxhit. Sa i përket deklarimeve nga prapësimi se me kreditorin është arritur marrëveshje e njofton gjykatën se debitori e ka bërë një pagesë në shumën prej 1,000 Euro mirëpo kjo pagesë debitorin nuk e liron nga detyrimi i tij dhe se debitori refuzon ti përmbahet marrëveshjeve me shkrim dhe nuk dëshiron të lidh marrëveshje të re, prandaj gjykatës i propozon që prapësimi i debitorve të refuzohet në tërësi si i pabazuar, ndërsa, në rast se prapësimi është paraqitur jashtë afatit ligjor, ta hedh poshtë si të pasafatshëm.

- Shqyrtimi i afatshmërisë të prapësimit të paraqitur nga debitori:

Fillimisht gjykata duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare dhe me propozimin e kreditorit, e shqyrtoj afatshmërinë e prapësimit dhe në rastin lëndor konstatoi se prapësimi i debitorit është paraqitur brenda afatit ligjor të paraparë në nenin 70 të LPP-së, e kjo mbështetur në shkresat e lëndës, gjegjësisht, nga fletëkthesa për dorëzim personal u konstatua se debitori Sh.A propozimin për përmbarrim të lejuar me urdhrin përmbarrimor të datës 14.02.2022 e ka pranuar me datën 18.02.2022, ndërsa, prapësimin e ka paraqitur me datën 24.02.2022 përmes postës rekomande (vërtetuar nga pliko/zarfi postar).

- Shqyrtimi i ligjshmërisë të urdhrin përmbarrimor dhe dokumentit përmbarrimor.

Gjykata vlerëson se dokumenti përmbarrimor me të cilin është lejuar përmbarrimi, pra, marrëveshja mbi kolateralin/pengun e inkorporuar në marrëveshjen për kredi të datës 31.08.2020 me qëllim të sigurimit të së njëjtës, është dokument përmbarrimor i përshtatshëm për përmbarrim ashtu siç përcaktohet në nenin 22 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore dhe nenin 5 paragrafi 2 nën paragrafi 1.7a) të Ligjit 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, ku shprehimisht përcaktohet se: “1. Dokumente përmbarruese janë: 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut”. Në këtë drejtim, marrëveshja në fjalë i plotëson kushtet ligjore në kuptim të dispozitës së lartëcekur pasi që në harmoni me ligjin kjo marrëveshje është regjistruar në regjistrin e pengut sipas ligjeve të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe atë pranë Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë të vertetuara përmesë: Konfirmimit të Regjistrimit R:20201223-150, R-20190816-303, R-20201223-150 dhe R-20190816-3030.

Po ashtu në rastin konkret gjykata vlerëson dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim edhe konform nenit 27 paragrafi 1 i LPP-së, ku shprehimisht përcaktohet se: “Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit.”, ngase i njëjti i përmban të gjitha elementet e nevojshme të cilat dokumentin e bëjnë të përshtatshëm për përmbarrim.

Për më tepër, gjykata analizoj edhe pretendimet e tjera nga prapësimi por të cilat i konsideroj si të pa ndikim për vendosje ndryshe, e po ashtu, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke u mbështetur në nenin 69 paragrafi 4 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore i cili përcakton se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, e që në rastin konkret debitori nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do t’i mbështeste pretendimet e tij.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së Saccoccia kundër Austrisë (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën e çështjes, gjykata u bazua në nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përfundimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.

Nga arsyet e theksuara me lartë, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile
PPP.nr.13/22 data 29.03.2024

Gj y q t a r j a
Lirika Sylaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.